| <p>1. Ndërmarrësi është i obliguar të elaborojë dhe të publikojë rregullat e veta të sigurisë që mundësojnë mbrojtjen e stafit, konsumatorëve, pronës dhe rrjetit gjatë ndërtimit, rindërtimit, heqjes, instalimit dhe çinstalimit për kryerjen e aktiviteteve të përcaktuara në këtë Rregullore.</p> <p>2. Nëse kabloja apo gypi kabllor instalohet nën trotuar, duhet vendosur një shirit paralajmërues kuq e bardhë mbi kablo apo gypin kabllor, ku distanca ndërmjet shiritit dhe kabllor apo gypit kabllor nuk mund të jetë më e vogël 0.2 m.</p> <p>3. Nëse kabloja apo gypi kabllor instalohet në vende që nuk janë trotuar, distanca mes sipërfaqes dhe shiritit nuk mund të jetë më e vogël se 0.4 m.</p> <p>4. Zonat e mbrojtjes të infrastrukturës për kablo/gyp kabllor nëntokësor:</p> <p>4.1. Distanca e zonës së mbrojtjes së kabllorëve nga kabloja apo gypi i fundit (skajshëm) nuk mund të jetë më pak se 1 m në njërën anë dhe 1 m në anën tjetër, të dyja të matura horizontalisht;</p> <p>4.2. Distanca minimale e thellësisë mes skajit të kabllor dhe sipërfaqes së trotuarit nuk mund të jetë më pak se 0.8 m;</p> | <p>1. Entrepreneur is obliged to elaborate and publish their safety rules which will ensure the protection of staff, customers, property, and network during the construction, re-construction, removing, installation and uninstallation during the activities set in this Regulation.</p> <p>2. If a cable or a cable duct is installed under the pedestrian, the red and white warning tape has to be placed above the cable or cable duct, where the distance between tape and cable or cable duct cannot be less than 0.2 m.</p> <p>3. If a cable or a duct is installed in other places other than the pedestrian, the distance between the surface and tape cannot be less than 0.4 m.</p> <p>4. Protection zones for underground infrastructure cabling/ducts:</p> <p>4.1 Minimum cable protection zone distance from the last cable or duct should be no less than 1 m on one side and 1 m on the other side, both measured horizontally.</p> <p>4.2 Minimum depth distance between the top of the cable and the surface of the pedestrians should be no less than 0.8 m.</p> | <p>1. Preduzetnik je dužan da izradi i objavi svoja bezbednosna pravila koja omogućavaju zaštitu zaposlenih, potrošača, imovine i mreže prilikom izgradnje, rekonstrukcije, uklanjanja, instaliranja i deinstaliranja za sprovođenje aktivnosti navedenih u ovom Pravilniku.</p> <p>2. Ako se kabl ili kablovska cev instalira ispod trotoara, mora se postaviti upozoravajuća crveno-bela traka iznad kabla ili kablovske cevi, pri čemu rastojanje između trake i kabla ili kablovske cevi ne može da bude manja od 0,2 m.</p> <p>3. Ako se kabl ili kablovska cev instalira na mestima koja nisu trotoari, rastojanje između površine i trake ne može da bude manja od 0,4 m.</p> <p>4. Zone zaštite infrastrukture za podzemni kabl/kablovsku cev:</p> <p>4.1 Rastojanje zone zaštite kablova od kabla ili poslednje (krajnje) cevi ne može biti manje od 1 m sa jedne strane i 1 m sa druge strane, oba merena horizontalno.</p> <p>4.2 Minimalno rastojanje po dubini između ruba kabla i površine trotoara ne može biti manje od 0,8 m.</p> |



|   |  |  |
|---|--|--|
| <p>4.3. Distanca minimale e thellësisë mes skajit të gypit kabllor dhe sipërfaqes së trotuarit nuk mund të jetë më pak se 0.4 m;</p> <p>4.4. Distanca minimale e thellësisë mes skajit të gypit kabllor dhe sipërfaqes së trotuarit në të gjitha rastet tjera nuk mund të jetë më pak se 0.6 m.</p> <p>5. Nëse kalohet përmes një infrastrukture tjetër, duhet negociuar mënyra e kryqëzimit të tyre. Dimensionet e lartpërmendura mund të mos vlejné për këtë rast. Duhet referuar në Tabelën 4 dhe Tabelën 5 të Shtojcës 4 të kësaj Rregullore për distancat minimale ndërmjet infrastrukturës së komunikimeve elektronike dhe infrastrukturave tjera.</p>      | <p>4.3 Minimum depth distance between the top of the duct and the surface of the pedestrians should be no less than 0.4 m.</p> <p>4.4 Minimum depth distance between the top of duct and the surface of all the other cases should be no less than 0.6 m.</p> <p>5. If you cross another infrastructure, negotiation is needed for how to cross it. The mentioned dimensions may not apply for this case. Refer to the Table 6 and Table 8 of the Annex 4 of this Regulation for the minimum distances between Telecom Infrastructure and other infrastructures.</p>   | <p>4.3 Minimalno rastojanje po dubini između ruba kablovske cevi i površine trotoara ne može biti manje od 0,4 m.</p> <p>4.4 Minimalno rastojanje po dubini između ruba kablovske cevi i površine trotoara u svim drugim slučajevima ne može biti manje od 0,6 m.</p> <p>5. Ako se vrši prelaz preko neke druge infrastrukture, mora se pregovarati o načinu njihovog ukrštanja. Gore navedene dimenzije mogu da se ne primenjuju na ovaj slučaj. Pogledati Tabelu 4 i Tabelu 5 Priloga 4 ovog Pravilnika za minimalna rastojanja između elektronske komunikacione infrastrukture i drugih infrastruktura.</p>                 |
| <p style="text-align: center;"><b>Neni 8</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Kërkesat për fillimin e punimeve të ndërtimit dhe instalimit</b></p> <p>1. Para fillimit të punëve të ndërtimit të jashtëm dhe të punëve të instalimit të jashtëm, në rast të pengimit të trafikut, entiteti që është përgjegjës për punët ndërtimore duhet të marrë lejen nga komuna përkatëse. Duhet referuar Shtojcës 2 të kësaj Rregullore për formën e lejes së punës për ndërtim të infrastrukturës së komunikimeve elektronike.</p> <p>2. Për të marrë lejen nga komuna përkatëse, ndërmarrësi duhet të dorëzojë:</p> <p>2.1. Kopjen e projektit me të gjitha lejet</p> | <p style="text-align: center;"><b>Article 8</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Requirements for starting the construction and installation work</b></p> <p>1. Before starting the outdoor construction work or the outdoor installation, that impede road traffic, the entity who is responsible for the construction work has to obtain the permission from the relevant municipality. Refer to the Annex 2 of this regulation for the Construction Permission Form.</p> <p>2. To obtain the permission from the respective municipality, the entrepreneur shall submit:</p> <p>2.1 Copy of the project with all the valid</p> | <p style="text-align: center;"><b>Član 8</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Zahtevi za otpočinjanje građevinskih i instalaterskih radova</b></p> <p>1. Pre otpočinjanja spoljnih građevinskih radova i spoljnih instalaterskih radova, u slučaju ometanja saobraćaja, subjekat koji je odgovoran za građevinske radove treba da dobije radnu dozvolu nadležne opštine. Videti Prilog 2. ovog Pravilnika za obrazac radne dozvole za izgradnju elektronske komunikacione infrastrukture.</p> <p>2. Za dobijanje dozvole od odnosne opštine, preduzetnik treba da dostavi:</p> <p>2.1 Kopiju projekta sa svim važećim</p> |

|  |  |   |
|--|--|---|
| <p>e vlefshme;</p> <p>2.2. Kopja e Aktit të Ekspertizës në rast se kërkohet me ligjet e aplikueshme nëse është e domosdoshme;</p> <p>2.3. Kopja e marrëveshjes me pronarin e tokës, nëse toka është pronë private;</p> <p>2.4. Orët dhe ditët se kur do të zhvillohen punimet.</p> <p>3. Komuna nuk mund të refuzojë kërkesën për leje nëse ndërmarrësi ka dorëzuar të gjitha dokumentet e kërkuara.</p> <p>4. Komuna apo komunat duhet të njoftojnë ndërmarrësin brenda periudhës prej njëzetë (20) ditë pune në lidhje me kërkesën e ndërmarrësit për fillimin e punimeve të ndërtimit dhe instalimit të jashtëm. Nëse brenda njëzetë (20) ditë pune ndërmarrësi nuk njoftohet, atëherë kjo do të konsiderohet si e aprovuar.</p> <p>5. Të gjitha punimet ndërtimore duhet bërë në pajtim me Shtojcën 4 të kësaj Rregulloreje.</p> <p>6. Nuk është e domosdoshme të kërkohet leja për të filluar instalimet e brendshme nëse është e pranueshme sipas nenit 5 të kësaj Rregulloreje.</p> | <p>acceptances;</p> <p>2.2 Copy of Act of Expertise in case it is required by the applicable laws if necessary;</p> <p>2.3 Copy of the agreement with the owner of the land, if the land is private property;</p> <p>2.4 Daytime and week-days when the work will be done.</p> <p>3. Municipality cannot refuse the request for permission if the entrepreneur has submitted all the requested documents.</p> <p>4. Municipality or municipalities must notify the entrepreneur, within a twenty (20) working day period, regarding the request of the entrepreneur for starting the outdoor construction and installation works, and if entrepreneur is not notified within twenty (20) working days, it shall be considered as approved.</p> <p>5. All construction work has to be done according to Annex 4 of this Regulation.</p> <p>6. It is no necessary to ask for any permission to start indoor installations if it is accepted according to Article 6 of this Regulation.</p> | <p>dozvolama;</p> <p>2.2 Kopiju akta o ekspertizi u slučaju da je propisan važećim zakonima, ako je neophodno;</p> <p>2.3 Kopiju ugovora sa vlasnikom zemljišta, ako je zemljište privatno vlasništvo;</p> <p>2.4 Sate i dane kada će se izvoditi radovi.</p> <p>3. Opština ne može da odbije zahtev za dozvolu ako je preduzetnik dostavio svu potrebnu dokumentaciju.</p> <p>4. Opština ili opštine moraju da obaveste preduzetnika u roku od dvadeset (20) radnih dana u vezi sa zahtevom preduzetnika za započinjanje radova spoljne izgradnje i instaliranja. Ako preduzetnik ne bude obavешten u roku od dvadeset (20) radnih dana, tada će se isti smatrati usvojenim.</p> <p>5. Svi građevinski radovi moraju biti izvedeni u skladu sa Prilogom 4 ovog Pravilnika.</p> <p>6. Nije neophodno tražiti dozvolu za otpočinjanje unutrašnjih instalacija ako je prihvatljivo prema članu 5 ovog Pravilnika.</p> |
|--|--|---|

|  |  |   |
|--|--|---|
| <p>7. Leja për fillimin e punimeve ndërtimore të brendshme duhet të merret vetëm nga pronarët e ndërtesës.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 9</b><br/><b>Informatat në situata urgjente</b></p> <p>1. Në rast të aksidenteve, kur komponentët e infrastrukturës janë dëmtuar, operatori është i obliguar të informoj komunën për aktivitetet urgjente për të rikthyer rrjetin në funksion:</p> <p>1.1 Nëse ndërmarrësi planifikon të rikthej rrjetin gjatë orarit të punës, ai duhet të njoftojë komunën së paku dy (2) orë para se të fillojë aktiviteti i restaurimit;</p> <p>1.2 Nëse ndërmarrësi ka pranuar informatën për rrjetin e dëmtuar jashtë orarit të punës por planifikon të rikthej rrjetin gjatë orarit të punës, ai duhet të informojë komunën dy (2) orë para se të fillojë aktiviteti i restaurimit;</p> <p>1.3 Nëse ndërmarrësi ka pranuar informatën për rrjetin e dëmtuar jashtë orarit të punës dhe ka filluar punën e rikthimit të rrjetit para fillimit të orarit të punës, ai duhet të informojë komunën menjëherë me fillimin e orarit të punës.</p> <p>2. Komuna duhet të përgjigjet në informacionin e pranuar jo më vonë se një</p> | <p>7. The permission to start indoor construction work has to be obtained only by the owners of the property.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 9</b><br/><b>Information in Urgent situations</b></p> <p>1. In case of accident were the infrastructure components will be damaged, the entrepreneur is obliged to inform the municipality about urgent activities to restore the network:</p> <p>1.1 If the entrepreneur plans to restore the network during working hours, he has to inform the municipality at least 2 hours before activities will be started.</p> <p>1.2 If the entrepreneur has received information about the damaged network during non-working hours but plans to restore the network during working hours, he has to inform the municipality two (2) hours before the restoration activities will be started.</p> <p>1.3 If the entrepreneur has received information about the damaged network during non-working hours and plans to restore the network during non-working hours, he has to inform the municipality the next working hour.</p> <p>2. The municipality has to answer to received information no later than 1 hour</p> | <p>7. Dozvolu za otpočinjanje unutrašnjih građevinskih radova treba dobiti samo od vlasnika zgrade.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 9</b><br/><b>Informacije u hitnim situacijama</b></p> <p>1. U slučaju nesreća, kada su komponente infrastrukture oštećene, operator je dužan da obavesti opštinu o hitnim aktivnostima za ponovno vraćanje mreže u funkciju:</p> <p>1.1 Ako operator planira da ponovo vrati mrežu u funkciju u toku radnog vremena, on mora da obavesti opštinu najmanje dva (2) sata pre početka aktivnosti restauracije.</p> <p>1.2 Ako je operator primio informaciju o oštećenju mreže van radnog vremena, ali planira da ponovo vrati mrežu u funkciju u toku radnog vremena, on mora da obavesti opštinu dva (2) sata pre početka aktivnosti restauracije.</p> <p>1.3 Ako je operator primio informaciju o oštećenju mreže van radnog vremena i započeo radove na vraćanju mreže u funkciju pre početka radnog vremena, on mora da obavesti opštinu odmah nakon početka radnog vremena.</p> <p>2. Opština mora da odgovori na primljenu informaciju u roku od ne više od 1 sata u</p> |
|--|--|---|

|   |  |   |
|---|--|---|
| <p>(1) orë gjatë orarit të punës.</p> <p>3. Në rastin e përshkruar në nënparagrafin 1.3, operatori mund të fillojë rikthimin e rrjetit sa më shpejtë që është e mundur.</p> <p>4. Nëse komuna nuk kthen përgjigje, ndërmarrësi mund të fillojë punën e restaurimit.</p> <p>5. Ky nen nuk aplikohet për punimet urgjente në rrugët për këmbësorë, rrugë dhe vende tjera ku aktivitetet urgjente për restaurimin e rrjetit nuk kufizojnë trafikun rrugor.</p>   | <p>during working days.</p> <p>3. In case described in subparagraph 1.3, the entrepreneur can start to restore the network as soon as possible.</p> <p>4. If the municipality does not answer, the entrepreneur can start the restoration work.</p> <p>5. This article applies to urgent works on the streets, roads, and other places where urgent restoration activities will make limitation on the road traffic</p>  | <p>toku radnog vremena.</p> <p>3. U slučaju opisanom u tački 1.3, operator može da počne sa ponovnim vraćanjem mreže u funkciju što je brže moguće.</p> <p>4. Ako opština ne vrati odgovor, operator može da započne radove na restauraciji.</p> <p>5. Ovaj član se ne odnosi na hitne radove na pešačkim stazama, putevima i drugim mestima gde hitne aktivnosti za restauraciju mreže ne ograničavaju drumski saobraćaj.</p>  |
| <p style="text-align: center;"><b>Neni 10<br/>Mbikëqyrja</b></p> <p>1. Komunat duhet të sigurojnë mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit dhe instalimit të jashtëm gjatë gjithë procesit të ndërtimit në territorin komunës përkatëse.</p> <p>2. Nëse puna ndërtimore bëhet në afërsi apo që kryqëzohet me infrastrukturën e një pronari tjetër, entiteti përgjegjës për punimet ndërtimore duhet të kërkojë mbikëqyrje nga pronarët e asaj infrastrukture.</p> <p>3. Entiteti përgjegjës për punimet ndërtimore duhet të kërkojë mbikëqyrje nga entitetet tjera nëse kërkohet me akte të tjera ligjore.</p> <p>4. Inspektimi i punimeve ndërtimore dhe instalimeve të jashtme bëhet nga</p> | <p style="text-align: center;"><b>Article 10<br/>Supervision</b></p> <p>1. Municipalities have to provide construction and outdoor installation supervision during all the construction process on the territory of that municipality.</p> <p>2. If the construction work is provided nearby or crossing another owner's infrastructure, the entity responsible for the construction work has to ask for the supervision from the owners of that infrastructure.</p> <p>3. The entity responsible for the construction work has to ask for the supervision from other entities if it is required by other legal acts.</p> <p>4. Inspection of Construction and outdoor installation shall be done from the</p> | <p style="text-align: center;"><b>Član 10<br/>Nadzor</b></p> <p>1. Opštine moraju da osiguraju nadzor spoljašnjih građevinskih i instalaterskih radova tokom procesa izgradnje na teritoriji dotične opštine.</p> <p>2. Ako se građevinski radovi izvode u blizini ili se ukrštaju sa infrastrukturom drugog vlasnika, subjekat koji je odgovoran za građevinske radove treba da traži nadzor od vlasnika te infrastrukture.</p> <p>3. Subjekt koji je odgovoran za građevinske radove treba da traži nadzor od strane drugih subjekata ako je propisan drugim zakonskim aktima.</p> <p>4. Inspekciju spoljnih građevinskih i instalaterskih radova obavlja komunalna</p> |

|  |   |  |
|--|---|--|
| <p>Inspektorati Komunal.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 11</b><br/><b>Pranimi i projektit të plotë</b></p> <p>1. Pronari i infrastrukturës kërkon nga të gjitha entitetet të cilat kanë pranuar projektin, të japin opinionin për përfundimin e projektit sipas kompetencave të tyre.</p> <p>2. Entitetet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni duhet të ofrojnë opinionin e tyre brenda dhjetë (10) ditëve të punës nga pranimi i kërkesës me shkrim nga pronari i infrastrukturës.</p> <p>3. Nëse edhe pas dhjetë (10) ditëve të punës nuk merret përgjigje, kjo konsiderohet si pranim nga entiteti për përfundimin e projektit.</p> <p>4. Kompania ndërtimore që kryen punimet ndërtimore duhet të elaborojë aktet e pranimit për të gjitha punët e mbuluara ndërtimore sipas projektit, sipas Shtojcës 3 të kësaj Rregullore.</p> <p>5. Akti për punët e mbuluara ndërtimore duhet nënshkruar nga:</p> <p style="padding-left: 20px;">5.1. Përfaqësuesi i kompanisë ndërtimore;</p> <p style="padding-left: 20px;">5.2. Përfaqësuesi i projektuesit të</p> | <p>Municipality Inspectors.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 11</b><br/><b>Acceptance of the complete project</b></p> <p>1. Owner of the network requests all entities which accepted the project to give their opinion about the completion of the project according to their competences.</p> <p>2. Entities mentioned in paragraph 1 of this article have to give their opinion within ten (10) working days after receiving the written request from the owner of the network.</p> <p>3. If after ten (10) working days, answer will not be received, it means that this entity accepted the completion of the project.</p> <p>4. The construction company that provided all construction work has to elaborate acceptance acts for all hidden construction work according to the project, according to the Annex 3 of this Regulation.</p> <p>5. Act for hidden construction work has to be signed by:</p> <p style="padding-left: 20px;">5.1 Construction company representative;</p> <p style="padding-left: 20px;">5.2 Representative of the designer of the</p> | <p>inspekcija.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 11</b><br/><b>Prijem kompletnog projekta</b></p> <p>1. Vlasnik infrastrukture traži od svih subjekata koji su izvršili prijem projekta da daju mišljenje o završetku projekta u skladu sa svojim nadležnostima.</p> <p>2. Subjekti navedeni u stavu 1 ovog člana moraju da daju svoje mišljenje u roku od deset (10) radnih dana od dana prijema pismenog zahteva od vlasnika infrastrukture.</p> <p>3. Ako se odgovor ne dobije ni posle deset (10) radnih dana, to se smatra prijemom završetka projekta od strane subjekta.</p> <p>4. Građevinsko preduzeće koje obavlja građevinske radove treba da izradi akte o prijemu za sve pokrivene građevinske radove u skladu sa projektom, shodno Prilogu 3 ovog Pravilnika.</p> <p>5. Akt o pokrivenim građevinskim radovima treba da potpišu:</p> <p style="padding-left: 20px;">5.1 Predstavnik građevinskog preduzeća;</p> <p style="padding-left: 20px;">5.2 Predstavnik projektant projekta;</p> |
|--|---|--|

|  |   |  |
|--|---|--|
| <p>projektit;</p> <p>5.3. Përfaqësuesi i pronarit të rrjetit;</p> <p>5.4. Përfaqësuesi komunal apo përfaqësuesi i Ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën rrugore në rastin e rrugëve nacionale dhe rajonale.</p> <p>6. Pasi të kryhen procedurat e përmendura, si dhe të pranohen nënshkrimet nga entitetet e lartpërmendura, akti i pranimit duhet të hartohet dhe të nënshkruhet nga:</p> <p>6.1. Përfaqësuesi i pronarit të rrjetit;</p> <p>6.2. Përfaqësuesi i projektuesit të projektit;</p> <p>6.3. Përfaqësuesi i kompanisë së ndërtimit të rrjetit;</p> <p>6.4. Përfaqësuesi i komunës;</p> <p>6.5. Përfaqësuesi i pronarit, nëse prona nuk është publike.</p> <p>7. Akti i pranimit duhet të merret jo më vonë se një (1) muaj pas pranimit të informatës nga pronari i rrjetit.</p> <p>8. Në rast kontesti për mospranimin e punëve ndërtimore, palët mund t'i drejtohen gjykatës.</p> | <p>project;</p> <p>5.3 Representative of the network owner;</p> <p>5.4 Municipality representative or representative from the Ministry responsible for Infrastructure in case of regional and national roads;</p> <p>6. After the above mentioned procedures are completed and signatures are received from the above mentioned entities, the act of acceptance has to be created and signed by:</p> <p>6.1 Representative of the Owner of the network;</p> <p>6.2 Representative of the designer of the project;</p> <p>6.3 Representative of the construction network;</p> <p>6.4 Municipality representative;</p> <p>6.5 Representative of the Owner of the property if the property is not public owned.</p> <p>7. The decision has to be done no later than after one (1) month after receiving the information from the owner of the network.</p> <p>8. Dispute resolution for not acceptance of construction work, parties must go to the court.</p> | <p>5.3 Predstavnik vlasnika mreže;</p> <p>5.4 Predstavnik opštine ili predstavnik ministarstva nadležnog za putnu infrastrukturu u slučaju nacionalnih i regionalnih puteva.</p> <p>6. Nakon sprovođenja navedenih procedura i dobijanja potpisa od gore navedenih subjekata, sastavlja se akt o prijemu i isti potpisuju:</p> <p>6.1 Predstavnik vlasnika mreže;</p> <p>6.2 Predstavnik projektanta projekta;</p> <p>6.3 Predstavnik preduzeća koje je izgradilo mrežu;</p> <p>6.4 Predstavnik opštine;</p> <p>6.5 Predstavnik vlasnika, ako imovina nije javna.</p> <p>7. Akt o prijemu treba doneti najkasnije u roku od jedan (1) meseca od dana prijema informacije od vlasnika mreže.</p> <p>8. U slučaju spora zbog odbijanja prijema građevinskih radova, stranke se mogu obratiti sudu.</p> |
|--|---|--|

|  |   |   |
|--|---|---|
| <p>9. Në rast kontesti për mospranimin e punëve instaluese, palët mund t'i drejtohen Autoritetit për dhënie të opinionit.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 12<br/>Dispozitat kalimtare</b></p> <p>1. Komunat duhet të krijojnë një praktikë që gjatë investimeve të reja në infrastrukturë, të përfshijnë infrastrukturën nëntokësore të komunikimeve elektronike në zonat urbane.</p> <p>2. Pas datës 01 janar 2018 ndalohej instalimi i kabllave ajrore në zonat e trashëgimisë kulturore të zonave urbane.</p> <p>3. Para datës 01 janar 2019 komunat për zonat urbane duhet të elaborojnë planin për heqjen e të gjitha kabllave ajrore në zonat e trashëgimisë kulturore. Afati për heqjen e tyre nuk mund të jetë më shumë se data 31 dhjetor 2020.</p> <p>4. Komunat do të ofrojnë informacion sipas kërkesës së ndërmarrësit për mundësitë e zhvendosjes së infrastrukturës ajrore në atë nëntokësore</p> <p>5. Ndërmarrësit duhet të shenjojnë infrastrukturën ekzistuese jo më vonë se deri më datë 01 janar 2019.</p> | <p>9. Dispute Resolution for not acceptance of installation work of the electronic communications infrastructure, parties should go to the Authority to request an opinion.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 12<br/>Transition provisions</b></p> <p>1. Municipalities shall establish new practices related to new infrastructure developments, including include underground electronic communications infrastructure in urban areas.</p> <p>2. After 01 January 2018, the installation of overhead cables shall be prohibited in historical heritage areas of urban zones.</p> <p>3. Before the date 01 January 2019, Municipalities in urban areas have to elaborate a plan to remove all overhead cables in cultural heritage areas, deadline of the removable action should be no later than 31 December 2020.</p> <p>4. Municipalities will provide information upon request of the entrepreneur for possibilities of removal of air infrastructure into underground infrastructure.</p> <p>5. Entrepreneurs should mark their existing infrastructure no later than 01 January 2019.</p> | <p>9. U slučaju spora zbog odbijanja prijema instalaterskih radova, stranke mogu da se obrate Autoritetu radi davanja mišljenja.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 12<br/>Prelazne odredbe</b></p> <p>1. Opštine treba da ustale praksu da prilikom novih investicija u infrastrukturu uključuje i podzemne elektronske komunikacione infrastrukture na urbanim područjima.</p> <p>2. Nije dozvoljeno instaliranje vazdušnih (nadzemnih) kablova u zonama kulturnog nasleđa na urbanim područjima posle 01. januara 2018. godine.</p> <p>3. Opštine moraju pre 01 januara 2019 godine da izrade za urbana područja plan za uklanjanje svih vazdušnih (nadzemnih) kablova u zonama kulturnog nasleđa. Rok za njihovo uklanjanje ne može da bude kasnije od 31 decembra 2020 godine.</p> <p>4. Opštine će na zahtev operatora pružiti informacije o mogućnostima premeštanja vazdušne (nadzemne) u podzemnu infrastrukturu.</p> <p>5. Preduzetnici moraju da označe postojeću infrastrukturu najkasnije do 01 januara 2019 godine.</p> |
|--|---|---|

| <p align="center"><b>Neni 13</b><br/><b>Dispozitat përfundimtare</b></p>   | <p align="center"><b>Article 13</b><br/><b>Final provisions</b></p>  | <p align="center"><b>Član 13</b><br/><b>Završne odredbe</b></p>   |
|--|--|---|
| <p>1. Kërkesat e kësaj Rregulloreje janë të detyrueshme të zbatohen nga ndërmarrësit që duan të ndërtojnë apo instalojnë infrastrukturë të komunikimeve elektronike në të ardhmen.</p> <p>2. Kërkesat për shënjimin dhe dhënia e informacionit për infrastrukturën ekzistuese të komunikimeve elektronike duhet të aplikohet edhe për ndërmarrësit që kanë të ndërtuar apo instaluar infrastrukturë të komunikimeve elektronike para hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.</p> <p>3. Brenda tridhjetë e gjashtë (36) muajve pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, të gjithë ndërmarrësit ekzistues duhet të dorëzojnë te Ministria dhe Autoriteti informata të plota mbi infrastrukturën ekzistuese të komunikimeve elektronike në formë të përshtatshme për vendosje në atllasin elektronik (GIS), në pajtueshmëri me sistemin koordinativ zyrtar KosovaRef01. Ndërmarrësit janë të obliguar të fillojnë me ofrimin e këtij informacioni jo më vonë se pas dymbëdhjetë (12) muajve pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje dhe duke vazhduar me plotësimin e këtij informacioni në mënyrë proporcionale çdo tre muaj.</p> <p>4. Kërkesat teknike të përcaktuara sipas kësaj Rregullore fillojnë së zbatuari nëntë dhjetë (90) ditë pas hyrjes në fuqi të kësaj</p> | <p>1. Requirements of the present regulation shall be binding for application by entrepreneurs that will construct or install any electronic communications infrastructure after entry into force of this regulation.</p> <p>2. Requirements for marking and providing information about existing electronic communications infrastructure shall be applied also for entrepreneurs that have constructed or installed any electronic communications infrastructure before entry into force of this regulation.</p> <p>3. All existing entrepreneurs shall, within thirtysix (36) months after entry into force of this Regulation, submit to the Ministry and Authority full information on existing infrastructure of electronic communications in a form that is suitable for placement in electronic Atlas (GIS), in accordance with official coordinate system KosovaRef01. Entrepreneurs are obliged to start to provide this information no later than after twelve (12) months after entry into force of this Regulation and to continue to provide this information in quarterly basis proportionally.</p> <p>4. Technical requirements defined in this Regulation shall enter into force within ninty (90) days from the date of entry into</p> | <p>1. Zahteve iz ovog Pravilnika su dužni da sprovede preduzetnici koji žele ubuduće da postave elektronsku komunikacionu infrastrukturu.</p> <p>2. Zahtevi za označavanje i pružanje informacija o postojećoj elektronskoj komunikacionoj infrastrukturi se moraju primenjivati i na preduzetnike koji su izgrdili/instalirali elektronsku komunikacionu infrastrukturu pre stupanja na snagu ovog Pravilnika.</p> <p>3. U roku od Trideset šest (36) meseci od dana stupanja na snagu ovog Pravilnika, svi postojeći preduzetnici moraju dostaviti Ministarstvu i Autoritetu potpune informacije o postojećoj elektronskoj komunikacionoj infrastrukturi u obliku koji je podesan za unošenje u Elektronski atlas (GIS), u skladu sa zvaničnim koordinatnim sistemom KosovaRef01. Preduzetnici su dužni da počnu sa pružanjem ove informacije najkasnije do dvanaest (12) meseci od dana stupanja na snagu ovog Pravilnika i da nastave sa dopunom te informacije proporcionalno na svaka tri meseca.</p> <p>4. Tehnički uslovi propisani ovim Pravilnikom stupaju na snagu u roku od devedeset (90) dana od dana stupanja ovog</p> |



|  |   |   |
|--|---|---|
| <p>Rregullore.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 14<br/>Shtojcat</b></p> <p>1. Shtojcat e bashkëngjitura të kësaj Rregulloreje, janë pjesë përbërëse e saj:</p> <p>1.1 Shtojca 1: Minimumi i informatave që duhet dorëzuar në fazën e njoftimit për planifikimin (projektimin) e infrastrukturës së jashtme të komunikimeve elektronike;</p> <p>1.2 Shtojca 2: Forma e lejes së punës për ndërtim të infrastrukturës së komunikimeve elektronike;</p> <p>1.3 Shtojca 3: Forma për nënshkrim për Infrastrukturën e mbuluar (kabllo dhe gyp kabllor);</p> <p>1.4 Shtojca 4: Ndërtimet e brendshme, të jashtme dhe shtrimi i kabllove.</p> | <p>force of the Regulation.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 14<br/>Annexes</b></p> <p>1. The following Annexes attached to this Regulation, are integral part of it:</p> <p>1.1 Annex number 1: Minimum information that shall be provided for the notification of Planning (Designing) of the outdoor electronic communications infrastructure phase.</p> <p>1.2 Annex number 2: Construction Permit Form for construction of the electronic communications infrastructure.</p> <p>1.3 Annex number 3: Hidden Infrastructure (cable and duct) Form for signatures;</p> <p>1.4 Annex number 4: Indoor, Outdoor Constructions and Installations.</p> | <p>Pravilnika na snagu.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 14<br/>Prilozi</b></p> <p>1. Prilozi uz ovaj Pravilnik čine njegov sastavni deo:</p> <p>1.1 Prilog 1: Minimalne informacije koje treba dostaviti u fazi obaveštenja o planiranju (projektovanju) spoljne elektronske komunikacione infrastrukture.</p> <p>1.2 Prilog 2: Obrazac radne dozvole za izgradnju elektronske komunikacione infrastrukture.</p> <p>1.3 Prilog 3: Obrazac za potpis za pokrivenu infrastrukturu (kabl i kablovska cev).</p> <p>1.4 Prilog 4: Unutrašnji, spoljni radovi i polaganje kablova.</p> |
| <p style="text-align: center;"><b>Neni 15<br/>Hyrja në fuqi</b></p> <p>Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga Ministri i Zhvillimit Ekonomik.</p> <p style="text-align: right;">Blerand STAVILECI</p> <p style="text-align: right;">_____<br/>Ministër i Zhvillimit Ekonomik</p> <p>Prishtinë, më 08.05.2017</p>   | <p style="text-align: center;"><b>Article 15<br/>Entry into force</b></p> <p>This Regulation shall enter into force seven (7) days after it is signed by the Minister of Economic Development.</p> <p style="text-align: right;">Blerand STAVILECI</p> <p style="text-align: right;">_____<br/>Minister of Economic Development</p> <p>Prishtinë, on 08.05. 2017</p>  | <p style="text-align: center;"><b>Član 15<br/>Stupanje na snagu</b></p> <p>Ovaj Pravilnik stupa na snagu sedam (7) dana posle potpisivanja istog od strane ministra za ekonomski razvoj.</p> <p style="text-align: right;">Blerand STAVILECI</p> <p style="text-align: right;">_____<br/>Ministar Ekonomskog Razvoja</p> <p>Priština, 08.05. 2017</p>   |

**Shtojca 1: Minimumi i informatave që duhet dorëzuar në fazën e njoftimit për planifikimin/projektimin e infrastrukturës së jashtme të komunikimeve elektronike**

1. Minimumi i informatave që duhet dorëzuar janë:

1.1. Pronari i rrjetit;

1.2. Lloji i rrjetit dhe natyra e punës;

1.3. Territori i komunës apo komunave në të cilat planifikohet shtrirja e infrastrukturës;

1.4 Vendi ku punimet e ndërtimit dhe të instalimit janë planifikuar

1.5. Data e planifikuar e fillimit dhe përfundimit;

1.6. Personi kontaktues.

## Shtojca 2: Forma e lejes së punës për ndërtim të infrastrukturës së komunikimeve elektronike

---

Autoriteti kompetent komunal

### Leje pune për ndërtimin e infrastrukturës së komunikimeve elektronike

Nr. \_\_\_\_\_

1. Kryerësi i punimeve

---

*(emri dhe mbiemri i personit fizik, numri personal, vendi i banimit, numri i telefonit, e-mail adresa,*

---

*ose emri i personit juridik, emri i kompanisë, numri i regjistrimit, adresa, numri i telefonit)*

2. Lloji i ndërtimit (shenjëzo):

- Ndërtim i ri
- Instalim
- Rindërtim
- Çinstalim

3. Vendi i ndërtimit \_\_\_\_\_  
*(emri)*

4. Adresa e vendit të ndërtimit, ose në mungesë të adresës – lokacioni

5. Njësia/numri kadastral i tokës së caktuar për ndërtim (të plotësohet nëse është e aplikueshme)

6. Zona kadastrale (të plotësohet nëse është e aplikueshme)

7. Pronari i tokës, ose në mungesë të tij – poseduesi ligjor

---

*(emri dhe mbiemri i personit fizik, numri personal)*

---

*ose emri i personit juridik (kompanisë), numri i regjistrimit*

8. Pronari i ndërtimit, ose në mungesë të tij - poseduesi ligjor dhe/ose shfrytëzuesi (në rastin e rindërtimit ose çinstalimit)

---

*(emri dhe mbiemri i personit fizik, numri personal*

---

*ose emri i personit juridik (kompanisë), numri i regjistrimit*

9. Personi i autorizuar

---

*(emri dhe mbiemri i personit fizik, numri personal*

---

*ose emri i personit juridik (kompanisë), numri i regjistrimit*

10. Data e planit të ofruar \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.

Zyrtari përgjegjës i komunës

---

*(pozita, emri, mbiemri, nënshkrimi)*

---

(Data)

Kjo leje e punës për ndërtimin e infrastrukturës së komunikimeve elektronike, mund të kundërshtohet me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative, brenda intervalit kohor prej një (1) muaji nga hyrja në fuqi në përputhje me procedurat e përcaktuara.

---

*(emri i institucionit, adresa)*

**Shtojca 3: Forma për nënshkrim për Infrastrukturën e mbuluar (kablo dhe gyp kabllor)**

**1. Forma për nënshkrim për kabllot e rrjetave të komunikimeve elektronike të mbuluara**

Nr. \_\_\_\_\_

1. Emri i ndërtuesit të infrastrukturës së komunikimeve elektronike dhe lokacioni \_\_\_\_\_

2. Operatori i punëve ndërtimore \_\_\_\_\_

*(emri, mbiemri i personit fizik, numri personal, numri i telefonit ose/*

*emri i personit juridik, numri i regjistrimit)*

3. Komisioni:

3.1 Përfaqësuesi i punëkryesit \_\_\_\_\_

*(emri, mbiemri, pozita)*

3.2 Projektuesi \_\_\_\_\_

*(emri, mbiemri, pozita)*

3.3 Mbikëqyrësi teknik / përfaqësuesi i mbikëqyrësit teknik \_\_\_\_\_

*(emri, mbiemri, pozita)*

4. Komisioni ka kryer inspektimin e jashtëm të punëve, para se të mbulohet infrastruktura dhe inspektimin e cilësisë dhe të gjeturat janë:

4.1 Të plotësohet nga përfaqësuesi i punëkryesit::

4.1.1 në përputhje me skicat (vizatimet) e punës Nr. \_\_\_\_\_ përgjatë rrugëve \_\_\_\_\_

4.1.2 mbrojtja e ofruar nga mbitensioni është në \_\_\_\_\_ m thellësi,

e lidhjes së kabllit \_\_\_\_\_

me kabllin \_\_\_\_\_

4.1.3 të kryera gjatë implementimit tranzicional \_\_\_\_\_

4.1.4 Vendosi e kabllit në \_\_\_\_\_ m thellësi është sipas projektit

4.2 Të plotësohet nga projektuesi

Punët janë kryer në përputhje me projektin: \_\_\_\_\_

*(emri i projektuesit, numri i certifikatës ose*

\_\_\_\_\_ Nr. i projektit: \_\_\_\_\_

*emri i kompanisë, numri i regjistrimit, numri i licencës)*

4.3 Të plotësohet nga mbikëqyrësi teknik / përfaqësuesi i mbikëqyrësit teknik

Punët kanë devijuar nga plani i ndërtimit. Devijimet konsistojnë në: \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ *(Institucioni përgjegjës, numri i skicës, data)*

Nuk ka pasur asnjë devijim nga plani ndërtimit

## 5. Vendimi i komisionit

Shtrirja dhe instalimi i të gjitha kabllave të komunikimeve elektronike është kryer sipas planit, normave të ndërtimit, standardeve teknike dhe janë të pranueshme.

Ndërtuesi / përfaqësuesi i punëkryesit

\_\_\_\_\_ *(emri, mbiemri, nënshkrimi)*

Përfaqësuesi i projektuesit (nëse në kontratë është përfshirë projektuesi)

\_\_\_\_\_ *(emri, mbiemri, nënshkrimi)*

Mbikëqyrësi teknik / përfaqësuesi i mbikëqyrësit teknik

\_\_\_\_\_ *(emri, mbiemri, nënshkrimi)*

**2. Forma për nënshkrim për gypat kabllor të rrjetave të komunikimeve elektronike të mbuluara**

Nr. \_\_\_\_\_

1. Emri i ndërtuesit të infrastrukturës komunikuese elektronike dhe lokacioni

\_\_\_\_\_

2. Operatori i punëve ndërtimore \_\_\_\_\_  
(emri, mbiemri i personit fizik, numri personal, numri i telefonit ose/

\_\_\_\_\_ / emri i personit juridik, numri i regjistrimit)

3. Komisioni:

3.1 Përfaqësuesi i punëkryesit \_\_\_\_\_  
(emri, mbiemri, pozita)

3.2 Projektuesi \_\_\_\_\_  
(emri, mbiemri, pozita)

3.3 Mbikëqyrësi teknik / përfaqësuesi i mbikëqyrësit teknik \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
(emri, mbiemri, pozita)

4. Komisioni ka kryer inspektimin e punës së mbuluar (inspektim të jashtëm) dhe inspektimin e cilësisë dhe të gjeturat e tij janë:

4.1 Të plotësohet nga përfaqësuesi i punëkryesit:

Deklaroj se ndërtimi i gypave kabllor i komunikimeve elektronike (izolimit të gypave) është kryer sipas skicës Nr. \_\_\_\_\_ përgjatë rrugëve në vijim: \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

| Ndërmjet                         |                                  | Nr. i gypit kabllor | Gjatësia (m) | Diametri i brendshëm | Gjatësia e gypit (m) | Lloji i gypit | Thellësia e vendosjes së gypit* |
|----------------------------------|----------------------------------|---------------------|--------------|----------------------|----------------------|---------------|---------------------------------|
| prej (shembull. numri i pusetës) | deri (shembull. numri i pusetës) |                     |              |                      |                      |               |                                 |
|                                  |                                  |                     |              |                      |                      |               |                                 |
|                                  |                                  |                     |              |                      |                      |               |                                 |
|                                  |                                  |                     |              |                      |                      |               |                                 |

*Shënim. \* e matur nga skaji më i lartë i gypit.*

Punët janë kryer prej \_\_\_\_\_ deri \_\_\_\_\_  
*(data) (data)*

4.2. Të plotësohet nga projektuesi:

Punët janë kryer në përputhje me projektin: \_\_\_\_\_  
*(emri i projektuesit, numri i certifikatës ose*

\_\_\_\_\_*Nr. i projektit të ndërtuar* \_\_\_\_\_  
*emri i kompanisë, numri i regjistrimit, numri i licencës)*

4.3 Të plotësohet nga mbikëqyrësi teknik / përfaqësuesi i mbikëqyrësit teknik:

Punët kanë devijuar nga plani i ndërtimit. Devijimet konsistojnë në: \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_  
*(Institucioni përgjegjës, numri i skicës, data korresponduese)*

Nuk ka pasur asnjë devijim nga plani ndërtimit



## 5. Vendimi i komisionit

E gjithë shtrirja dhe instalimi i gypave kabllor të rrjetave të komunikimeve elektronike është bërë në përputhje me planin dhe kodet e ndërtimit, standardet teknike dhe janë të pranueshme.

Përfaqësuesi i punëkryesit

---

*(emri, mbiemri, nënshkrimi)*

Përfaqësuesi i projektuesit (nëse në kontratë është përfshirë projektuesi)

---

*(emri, mbiemri, nënshkrimi)*

Mbikëqyrësi teknik /përfaqësuesi i mbikëqyrësit teknik

---

*(emri, mbiemri, nënshkrimi)*

## **Shtojca 4: Ndërtimet e brendshme, të jashtme dhe instalimi i kablllove**

### **KAPITULLI I Ndërtimet e brendshme**

#### **Neni 1 Montimi i kablllove të komunikimit në hapësira të brendshme**

1. Kabllot e komunikimit në hapësira të brendshme mund të jenë:
  - 1.1 të montuara në mure;
  - 1.2 të shtrira në gypat kabllor të instaluar në mure;
  - 1.3 të shtrira në gypa kabllor apo kuti të fiksuara në mure.
2. Në lokacione të qasshme, kabllot e komunikimit duhet të montohen në mënyrë të mbyllur:
  - 2.1. në dollapë të deponimit, kulme dhe kabina teknike të objekteve, kabllot instalohen në gypa nën dysheme apo pozicionohen në mbajtëse të fiksuara në konstruksion;
  - 2.2. në shkallë, korridore dhe vende të tjera të qasshme në objekte, kabllot e komunikimit montohen në kanale kabllore të “trungut” (kanalit vertikal) dhe rrugë horizontale të instaluara në mure e dysheme gjatë ndërtimit të objektit, të cilat lidhen me pikat shpërndarëse të përgatitura enkas. Pajisjet kabllore munden, sipas nevojës, të vendosen në ato pika shpërndarëse.
3. Kabllot e komunikimit duhet shtrirë paralelisht me tavanin/dyshemenë apo në pjerrësinë e shkallëve ose në kënd të drejtë me tavanin/dyshemenë.
4. Në lokacione të qasshme, kabllot e komunikimit montohen në lartësi prej 2.2 m mbi nivelin e dyshemesë, të instaluara në gypa mbrojtës apo konstruksione të tjera të mbyllura.
5. Nëse kabllot e komunikimit duhet montuar të hapura në lokacione të qasshme, atëherë në hapësirat horizontale ndërmjet mureve, kabllot e tilla montohen jo më pak se 2.2 m mbi nivelin e dyshemesë, si dhe jo më afër se 0.1 m me tavanin.
6. Kabllot e komunikimit duhet të kryqëzohen me kabllot tjera në drejtime pingule, duke i shtrirë në gypa të tjerë mbrojtës.
7. Kabllot e komunikimit që instalohen paralelisht me kabllot e energjisë, duhet të montohen nën (më poshtë) kabllot e energjisë në distancë prej jo më pak se 25 mm. Nëse kabllloja nuk përmban pjesë metalike, ato mund të montohen edhe në afërsi deri në 10 cm.
8. Kabllot e komunikimit duhet të montohen në kanale kabllore të objektit pa dëmtuar kabllot tjera të komunikimit të vendosura në to.

9. Në pikën shpërndarëse, pajisjet shpërndarëse të kabllave të komunikimit montohen në konstruksionet mbajtëse apo konstruksionet e murit të objektit, duke ruajtur elementet e objektit dhe kabllot e komunikimit të montuara më parë.

10. Kabllot e komunikimit duhet të shtrihen në drejtim horizontal dhe vertikal nën kënd të drejt ( $90^0$ ), duke siguruar kërkesat për rrezen më të vogël të lejueshme të përkuljes për kabllot e komunikimit si dhe duke shmangur, për aq sa është e mundur, kryqëzimet me sistemet e energjisë elektrike, ujit, gazit, ngrohjes dhe me sistemet tjera inxhinierike në objekt.

11. Kur shtrihen disa kabllot të komunikimit, duhet të përdoret vetëm një rrugë, si dhe është e obligueshme që këto kabllot të komunikimit të fiksohen për muri dhe të mos përdridhen mes vete.

12. Kur montohen kabllot e komunikimit në mure apo mes dyshemeve të objektit, ato duhet vendosur në gypa mbrojtës. Kabllot e komunikimit nuk duhet të futen brenda tullave në konstruksione.

13. Në hapësira të brendshme, kabllot e komunikimit dhe pajisjet kabllore duhet shenjuar përgjatë “trungut” në secilin kat të objektit, në secilën pikë shpërndarëse, në secilën dhomë, si dhe në secilën prizë, ashtu që të mundësohet identifikimi i pronarit të kabllot të komunikimit.

14. Kutitë shpërndarëse që montohen jashtë murit në shkallët e objektit duhet instaluar në jo më pak se 2.2 m mbi nivelin e dyshemesë dhe jo më afër se 0.1 m me tavanin.

15. Kabinetet shpërndarëse, kutitë shpërndarëse, duhet instaluar në distancë prej jo më pak se 0.1 m nga këndet e mureve dhe skajeve të kornizës së dyerve, ashtu që të mos pengojnë hapjen dhe mbylljen e dyerve.

16. Në seksionet horizontale, kabllot e komunikimit duhet fiksuar në së paku tri (3) pika për metër, ndërsa në seksione vertikale – në së paku dy (2) pika për metër.

17. Në pikat e kryqëzimit të gypave të sistemeve të ndryshme inxhinierike, kabllot e komunikimit vendosen në tiplla të ngulitura në suvanë e murit nën to.

18. Kur kryqëzohen telat e sistemeve të ziles, sigurisë dhe alarmit të zjarrit që janë të fiksuara për muri, kabllot e komunikimit montohen mbi to.

19. Vendet e shpimit dhe tiplave në mure e pllaka dyshemeje ndërmjet kateve duhet mbyllur pas montimit të kabllave të komunikimit.

20. Kabllot e komunikimit nuk duhet të përdridhen përreth boshtit gjatësor.

21. Në lokacionet e prizës së kabllot së komunikimit, është e detyrueshme që të sigurohet një gjatësi e caktuar rezervë e kabllot së komunikimit, ashtu që të sigurohet mundësia e montimit të mëvonshëm të një njeje.

22. Pas përfundimit të punës së montimit, punishtja duhet të kthehet në gjendje të rregullt.

## **KAPITULLI II** **Ndërtimet e jashtme**

### **Neni 2** **Punimet e dheut**

1. Shtrimi i gypave kabllor dhe instalimi i pusetave, riparimet e tyre apo përdorimi i tyre zakonisht përfshin edhe punimet e dheut si në vijim:

- 1.1 gërmimi dhe rivendosja e rrugëve dhe trotuareve për këmbësorë;
- 1.2 gërmimi i gropave dhe kanaleve;
- 1.3 punët e përforcimit për gropa e kanale;
- 1.4 mbushja e gropave dhe kanaleve me dhe;
- 1.5 ngjeshja e dheut;
- 1.6 ngarkimi dhe heqja e dheut sipërfaqësor;
- 1.7 nivelimi i dheut dhe punë të tjera me dhe.

2. Kryerja e punimeve të dheut në afërsi të strukturave nëntokësore dhe sipërfaqësore dhe rrjeteve inxhinierike lejohet vetëm pas njoftimit paraprak të pronarëve të këtyre strukturave dhe rrjeteve inxhinierike ose në prani të tyre gjatë punimeve të ndërtimit.

3. Para fillimit të punimeve të dheut, lokacioni i vijës së ardhshme duhet shenjuar saktë sipas projektit. Kur shenjohej vija, duhet paraqitur:

- 3.1. linja boshtore e kanalit;
- 3.2. instalimet nëntokësore;
- 3.3. kabllot dhe rrjetet tjera inxhinierike nëntokësore që kryqëzohen me vijën.

4. Kur gërmohen gropa apo kanale në zona banimi, duhet instaluar rrethoja me shenja paralajmëruese përreth punishtes. Nëse punimet bëhen në rrugë apo përgjatë rrugës, duhet pasur kujdes që punishtja të shenjohej me shenjat e duhura rrugore, rrethoja dhe shërbime orientimi, dhe gjatë natës apo në dukshmëri të zvogëluar – me drita sinjalizuese.

5. Para fillimit të punimeve, drunjtë dhe pusetat përgjatë rrugës duhet mbrojtur nga mbulimi me dhe si dhe nga veturat. Duhet lënë rrugë për qasje në burime zjarrfikëse për kalim të lirë të automjeteve.

6. Për të siguruar qarkullimin e këmbësorëve dhe të automjeteve, duhet të vendosen ura të përkohshme mbi gropat. Urat në rrugë duhet kalkuluar për pesha jo më të vogla se dhjetë (10) tonë, derisa urat për rrugë të hyrjes në oborre – për pesha jo më pak se shtatë (7) tonë. Ura duhet të jetë aq e gjatë sa të mbahet në dheun natyror pas pjerrinës. Anët e gropës nën urat e vendosura duhet të përforcohen me pllaka.

### **Neni 3** **Struktura dhe thellësia e kanalit tokësor**

1. Kanali tokësor duhet të përbëhet nga këto pjesë:

- 1.1. shtresa e nivelimit;
- 1.2. shtresa e mbushjes fillestare;
- 1.3. shtresa e mbushjes finale.

2. Shtresa e nivelimit është shtresë që përbëhet nga produkte ndërtimore që formohen ose në dhe ose në strukturën e zgjedhur si bazë, si dhe është shtresa mbi të cilën do të shtrihen gypat. Trashësia e shtresës së nivelimit nuk mund të jetë më pak se 0.1 m. Madhësia maksimale e fraksionit të rërës, zhavorrit apo gurëve të thyer që përdoren për shtresën e nivelimit nuk mund të tejkalojë dhjetë (10) përqind të diametrit të gypit; por në asnjë rast, nuk mund të jetë më shumë se 20 mm. Nëse dheu përmbush kërkesat e këtij paragrafi, shtresa e nivelimit nuk nevojitet.

